

Prot. 123
DT-18.09.16



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 10779

Tiranë 9/14/2016

Drejtuar: **Z. Ardian Yzeiraj**
Administrator
Shoqëria "Qendra Sportive" sh.a
Adresa: Rrg: "Dritan Hoxha", Pallati Sporti "Asllan Rusi", Tiranë

Lënda: **Për ndryshimin e aksionerit të shoqërisë "Qendra Sportive" sh.a.**


I nderuar z. Yzeiraj,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 3.2.2016 "Për transferimin e së drejtës së pronësisë së shoqërisë "Qendra sportive" sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, te Bashkia Tiranë" pronësia e shoqërisë "Qendra Sportive" sh.a transferohet me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në pronësi të Bashkisë së Tiranës.

Sa më sipër, ju lutemi të ndiqni procedurat për ndryshimin e aksionerit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në favor të Bashkisë së Tiranës.

Ju urojmë punë të mbarë

Me respekt



Felipe Tosellari
Krye

Adresa: Sheshi "Skënderbej", nr.2, 1001, Tiranë, Shqipëri, tel: +355 4 226629, fax: +355422830



MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Nr. 842/2 Prot.
Datë 8/2 2016

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

Nr. 86, datë 3.2.2016

PËR

**TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË SË SHOQËRISË
"QENDRA SPORTIVE", SH.A., TIRANË, ME KAPITAL 100 PËR QIND
SHTETËROR, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TE BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëria "Qendra sportive", sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, aktualisht në pronësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, transferohet në pronësi të Bashkisë Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

ARBEN AHMETAJ

Felipe Tosellari
Krye